

Statuti

Në bazë të Ligjit Nr. -3/L - 73 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Ligjit Nr. -3/L - 256 për Ndryshim dhe Plotësim të Ligjit për Zgjedhjet, Ligjit Nr. -3/L - 72 për Zgjedhjet Lokale, të Ligjit Nr. -3/L - 174 për Financimin e Subjekteve Politike, si dhe të Rregullës Nr. 01/2013 të KOZ, Kuvendi i Partisë Socialdemokrate, i mbajtur me 17 Dhjetor 2106 miratoi këtë:

STATUT TË PARTISË SOCIALDEMOKRATE TË KOSOVËS

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1.

Me këtë Statut Partia Socialdemokrate rregullon dhe përcakton: emrin e saj, shenjen, selinë, qëllimet, mënyrën e informimit të opinionit, parimet e veprimit, të drejtat dhe obligimet e anëtarëve, format e organizimit, organet dhe trupat e Partisë, mënyrën e zgjedhjes dhe shkarkimit të tyre, emërimin dhe ndërrimit, kohëzgjatjes së mandatit, mjeteve për punë, ndërprerjen e punës, si dhe çështjet tjera me interes për anëtarësinë dhe punën e Partisë.

Statuti është akti themelor juridik i PSD.

Neni 2.

Partia Socialdemokrate e Kosovës (PSDK) e themeluar me 10 Shkurt 1990 në Prishtinë është parti e pavarur demokratike e anëtarëve të lirë dhe të përgjegjshëm të cilët veprojnë për të realizuar këto parime programore dhe qëllime:

- respektimin e njeriut, pacenueshmërinë e jetës, dinjitetin e tij, të drejtat dhe liritë, pavarësisht nga botëkuptimet, përkatësia etnike dhe fetare, moshë, gjinia, bindjet politike dhe statusi social;
- realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve, personave që jetojnë nga puna dhe në bazë të punës së tyre;
- afirmimin e të drejtave dhe lirive të individëve të lenë pas dore dhe të privuar nga të drejtat, grupeve shoqërore dhe shtresave si dhe të barazisë së gjinive;
- mbrojtjen e të drejtave të garantuara të njerëzve për mbrojtje shëndetësore, arsimim, mbrojtje sociale, në punë, familje e të tjera;
- mbrojtjen e pasurisë dhe të punës;
- realizimin e barazisë sociale dhe kombëtare të qytetarëve dhe të komuniteteve në Republikën e Kosovës;
- ndarjen e pushtetit legjislativ nga pushteti ekzekutiv dhe gjyqësor;
- realizimin e rendit demokratik politik e juridik në shtet dhe sundimin e ligjit dhe të drejtës sociale;
- zhvillimin e shoqërisë plurale, të drejtësisë dhe solidare, me kualitet të lartë të jetës për të gjithë punëtorët dhe shtresat shoqërore;
- mbrojtjen e pasurisë kulturore dhe natyrore, si dhe të ambientit jetësor;
- ruajtjen e vlerave të traditës e identitetit kombëtar;
- ruajtjen e paqes dhe sigurisë në Kosovë dhe rajon;
- integrimin e Kosovës në BE, NATO dhe strukturat e institucionet tjera ndërkombëtare dhe integrimi kombëtar shumëdimensional, si dhe integrimin e të gjitha komuniteteve në jetën publike dhe institucionale të Kosovës.

Neni 3.

Për realizimin e parimeve dhe qëllimeve politike nga neni 2. i këtij statuti, PSD, duke u nisur nga vlerat themelore të socialdemokracisë dhe Programi i PSD, parimet e legjitimitetit dhe legalitetit politik, shfrytëzon mjetet jo të dhunshme parlamentare dhe jashtëparlamentare dhe përjashton metodat tjera të dhunshme dhe format e mos tolerancës.

Neni 4.

Për realizimin e qëllimeve dhe të bazave programore PSD bashkëpunon me partitë politike dhe individët në Republikën e Kosovës dhe jashtë saj. PSD-ja synon të anëtarësohet në organizata ndërkombëtare të opsonit socialdemokrat dhe në organizmat e tyre.

Neni 5.

PSD-ja vepron në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Emri i plotë i Partisë është: Partia Socialdemokrate. Emri i shkurtër është: PSD. Krahas emrit të plotë, në veprimtarinë politike dhe qarkullimin juridik përdoret edhe emri i shkurtër.

Neni 6.

PSD ka cilësinë e personit juridik. PSD është organizatë jo fitimprurëse. PSD është e regjistruar në regjistrin e organizatave politike i cili evidentohet në organin shtetëror të Republikës së Kosovës (Zyrën për Regjistrimin të Partive Politike dhe Certifikim).

PSD-në e prezanton dhe përfaqëson kryetari i PSD-së. Kryetari i PSD-së mund të autorizoi persona tjerë që të prezantojnë dhe përfaqësojnë PSD-në në harmoni me këtë Statut.

Selia e PSD-së është në Prishtinë.

Neni 7.

PSD ka shenjen e vet e cila përbehet nga katrori i portokalltë (Panton 165 c), në të cilin është shkurtesa e emrit të partisë me shkronja të bardha të pjerrëta në këndin e djathtë në lartësi.

PSD ka flamurin ngjyrë të portokalltë në përmasën 1:1, katror, me shenjen e partisë nga neni paraprak.

PSD ka vulën e rrumbullakët me diametër prej 3 cm, katrorin me shkurtesën PSD në mes të këndit të poshtëm të rrethit, në rrethin e të cilit shkruan: Partia Socialdemokrate e Kosovës. Partia ka edhe vulën katrore. PSD në Kuvendin e tetë ka miratuar edhe himnin e vet - që është kompozimi i Rexho Mulliqit – “Baresha”.

Shfrytëzimi dhe ruajtja e vulës, vulave të formave të organizimit të PSD-së, shenjës, flamurit dhe himnit do të përcaktohet më për së afërmi me vendimin e Këshillit Drejtues.

Neni 8.

Puna dhe veprimi i PSD-së është publike dhe arrihet me veprimin publik të anëtarësisë, organeve të PSD-së në tubime publike, tribuna, me pjesëmarrje në tryezat e rrumbullakëta dhe në forma tjera, duke vendosur raporte dhe duke ndikuar në opinionin publik të qytetarëve, zgjedhësve, simpatizantëve dhe anëtarëve të PSD-së.

Veprimi publik sigurohet edhe përmes mbledhjeve dhe takimeve të organeve të PSD-së të hapura për opinion, konferencave për gazetarë, deklaratave dhe kumtesave për opinion.

Këshilli Drejtues mund të vendosi edhe për forma tjera të informimit si: botimin e gazetës, buletinit informativ, emisioneve në radio dhe TV.

Për nevoja hulumtuese dhe zhvillimore të Partisë KD mund të themeloi edhe institucione tjera në bazë të ligjit si institute, ente etj.

Organet e PSD-së mund të debatojnë dhe të vendosin edhe pa prezencën e opinionit për çështje të brendshme partiake.

Neni 9.

PSD ndanë tituj nderi, mirënjohje dhe shpërblime për kontributin e anëtarëve për afirmimin e Programit të Partisë.

Tituj nderi janë: Kryetar/e nderi dhe anëtar/re nderi e PSD.

Për ndarje të titullit Kryetar/re e nderit vendos Kuvendi.

Si mirënjohje PSD-ja mund të ndaj medalje të Partisë, shenja dhe diploma.

Dispozitat më të hollësishme për mirënjohjet e Partisë dhe për anëtar nderi i përcakton dhe ndan Këshilli Drejtues, në raste solemne dhe me vendim të posaçëm.

Mirënjohje mund t’ u ndahen edhe individëve e institucioneve.

2. ANËTARËSIA

Neni 10.

Anëtar i PSD-së mund të bëhet qytetari i moshës madhore i Republikës së Kosovës i cili vullnetarisht nënshkruan deklaratën për anëtarësim me të cilën deklarohet së është i informuar dhe së pranon Statutin dhe Programin e PSD-së.

Vendimin për pranim në anëtarësi e merr organi drejtues në organizatën themelore, në nivel të degës, Këshilli Drejtues i degës, respektivisht zyrtari i autorizuar. Çdo anëtar i përket degës komunale të PSD-së, sipas vendbanimit. Përjashtimisht, nxënësit dhe studentet mund të jenë anëtar të organizatës sipas vendqëndrimit.

Anëtarësimi në PSD dhe organet e saj mund të jetë i nderit. Vendimin për pranim në anëtarësi të nderit e bie Kryesia e PSD-së. Për anëtarët e nderit mbahet evidencë e veçantë.

Anëtari i PSD nuk mund të jetë anëtar i ndonjë partie tjetër me seli në Republikën e Kosovës.

Për anëtarët e PSD-së mbahet regjistri i anëtarëve, pamjen dhe përmbajtjen e të cilit e përcakton Këshilli Drejtues i PSD-së me Rregullore të posaçme.

Neni 11.

Anëtari ka të drejta dhe obligime:

- të merr pjesë në përcaktimin dhe realizimin e politikës së partisë;
- të respektoj ligjet dhe normat etike, si dhe të jetë përgjegjës për deklaratat publike që i jep në emër të Partisë;
- të respektoj Statutin dhe Programin e PSD-së si dhe të zbatoi vendimet e organeve të saj;
- me veprimet dhe sjelljet e veta t' i kontribuoi autoritetit të Partisë në opinion;
- pavarësisht të merr iniciativa të cilat janë në harmoni me Statutin dhe Programin, si dhe me qëndrimet e Partisë;
- së bashku me anëtarët e tjerë mund të organizojë fraksion të veçantë politiko-programor brenda Partisë;
- të zgjedh dhe të zgjidhet në të gjitha organet e Partisë;
- të jetë i kandiduar në listat e PSD-së për zgjedhje parlamentare dhe lokale;
- të jetë i (e) informuar për aktivitetet e PSD-së;
- në harmoni me dispozita të veçanta të pranoi ndihmë solidare të PSD-së, posaçërisht në rast të cenimit të të drejtave të tij për shkak të anëtarësimit në Parti;
- të marr pjesë në të gjitha aktivitetet e Partisë;
- të realizoi të drejta tjera dhe të përmbushë obligime tjera në harmoni me Statutin dhe vendimet e miratuara në bazë të Statutit.

Neni 12.

Anëtari i PSD-së është i obliguar të paguaj rregullisht kuotizacionin.

Kuotizacioni paguhet në llogarinë rrjedhëse të PSD-së ose nga arkëtarët e degëve.

Lartësia e kuotizacionit varet nga lloji i të ardhurave dhe gjendja sociale e çdo anëtari:

- për të punësuarit,
- për të papunësuarit, nxënësit studentët dhe pensionistët,
- për anëtarët të cilët realizojnë kompensime që burojnë nga mandati i PSD,
- për anëtarët të cilët marrin rregullisht pagë nga mandati i PSD-së.

Obligimet dhe të drejtat nga paragrafi i mësipërm nga ky nen përcaktohen me vendim të posaçëm të Këshillit Drejtues.

Anëtari mund t' i japi edhe mbështetje materiale PSD-së në formë të donacionit dhe të formave tjera të ndihmës.

Për shkak të dhënies së ndihmës materiale PSD-së askush nuk mund të realizoi të drejta shtesë ose të posaçme.

Neni 13.

Anëtari i cili nuk ka paguar kuotizacionin për gjashtë ose më shumë muaj, pa justifikim, nuk mund të jetë kandidat për funksione partiake ose kandidat i PSD-së për trupin përfaqësues të njësisë

lokale të vetëqeverisjes dhe përfaqësues në Kuvendin e Kosovës, si dhe humbë të drejtën të jetë i zgjedhur dhe të zgjedh në të gjitha nivelet brenda partiake.

Neni 14.

Zyrtari/ët për financa të Stafit Profesional i PSD-së ka obligim që për çdo gjashtë muaj të informoi degët komunale për përmbushjen e obligimit të anëtarëve nga territori i vet për pagesën e kuotizacionit.

Neni 15.

Anëtarësia në PSD ndërpritet:

- në rastet e parapara me ligj,
- me daljen nga partia (me shkrim ose duke kthyer librezën e anëtarësisë),
- me shlyerjen nga evidenca,
- me miratimin e vendimit definitiv për përjashtim,
- me anëtarësimin në parti tjetër ose me kandidimin në listën ndonjë partie tjetër politike, apo në listë të pavarur pa pëlqimin e PSD-së,
- me vendimin definitiv për shpërndarjen e formës së organizimit të PSD-së në të cilën ka qenë i anëtarësuar.

Neni 16.

Anëtari shlyhet nga evidenca për shkak të mos aktivitetit që konstatohet me vendim të organit përkatës.

Anëtari shlyhet nga evidenca e anëtarësisë pasi që një vit, pa justifikim, nuk paguan kuotizacionin.

Vendimin për shlyerje nga evidenca e bie Këshilli Drejtues i komunës, respektivisht ai i degës. Vendimi nga paragrafi 1. dhe 2. anëtarit/ës duhet t' i dërgohet në formë të shkruar me arsyetim.

Anëtari/ja në afat prej 15 ditësh mund t' i ankohet Këshillit Mbikëqyrës të PSD-së të Kosovës i cili është i obliguar të vendos për ankesën në afat prej 15 ditësh.

Deri në plotfuqishmërinë e vendimit të drejtat dhe obligimet e anëtarit pushojnë.

Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës të PSD-së është definitiv.

Neni 17.

Pasi që anëtarësia i është ndërpre me shlyerje nga evidenca, anëtari i mëparshëm mund të anëtarësohet në PSD në harmoni me Statutin.

Neni 18.

Kundër anëtarit sjellja dhe veprimi i të cilit është drejtuar kundër vendimeve të organeve të partisë ose me vepra të pandershme dhe veprime të vrazhda ka shkelur Statutin, parimet programore dhe qëllimet e Partisë dhe me këtë dëmton autoritetin e saj, zhvillohet procedurë partiake.

Në procedurën partiake mund të shqiptohen masat:

- Vërejtje,
- Marrja e përkohshme e të drejtës së kryerjes së funksioneve të caktuara ose të gjitha funksioneve deri në dy vjet,
- Përjashtimi nga Partia.

Vërejtja mund të shqiptohet për forma të lehta të shkeljeve nga paragrafi 1. i këtij neni, me të cilat i është shkaktuar dëm më i vogël Partisë.

Marrja e përkohshme e të drejtës së ushtrimit të funksioneve të veçanta ose të të gjitha funksioneve deri në më së shumti dy vjet mund t' i shqiptohet anëtarit i cili me veprimet e veta i ka sjellë dëm të lehtë Partisë dhe kur vlerësohet së kjo masë do të ketë ndikim pozitiv në veprimet e tij të mëtejshme, aktivitetin dhe veprimin në Parti.

Përjashtimi nga Partia mund t' i shqiptohet anëtarit për forma të rënda të shkeljes nga paragrafi 1. i këtij neni, me të cilat i është sjellë dëm i konsiderueshëm Partisë.

Neni 19.

Vendimin për vërejtje respektivisht për përjashtim mund ta bie Këshilli Drejtues i degës me iniciativë të vet ose në bazë të propozimit për përcaktimin e përgjegjësisë, të cilin mund ta bie Këshilli Drejtues i PSD të Kosovës.

Përjashtimisht, Kryesia e PSD të Kosovës mund ta suspendoi menjëherë nga të gjitha funksionet anëtarin/ën dhe t' i propozoi Këshillit Drejtues që nga PSD-ja të përjashtohet anëtari, nëse vlerëson se sjellja dhe veprimi i tij nga neni 18. paragrafi 1. i këtij Statuti në atë masë e dëmton autoritetin e PSD-së, që nuk mund të zhvillohet procedura e rregullt partiake.

Vendimin për përjashtim të anëtarit/ës e bie Këshilli Drejtues me propozim të Kryesisë në afat prej 8 ditësh. Në vendimin e miratuar në këtë mënyrë anëtari i përjashtuar mund t' i ankohet Këshillit Mbikëqyrës të PSD-së i cili është i obliguar që për ankesën të vendosi në afat prej 15 ditësh.

Vendimin për marrjen e përkohshme të së drejtës për ushtrim të funksioneve të veçanta ose të të gjitha funksioneve deri në dy vjet e bie Këshilli Drejtues i degës për funksionet në organizatën komunale, dhe Këshilli Drejtues i PSD për funksionet në organet e PSD të Kosovës.

Në procedurën partiake duhet të theksohen vërejtjet, provat (deklaratat e dëshmitarëve, dokumentet). Bazë për aprovim të vendimit është shqyrtimi gojor.

Në shqyrtim detyrimisht ftohet anëtari/ja kundër të cilit udhëhiqet procedura dhe atë në të gjitha nivelet e procedurës. Këshilli Drejtues i degës para të cilit zhvillohet procedura partiake, respektivisht Këshilli Mbikëqyrës i PSD të Kosovës para të cilit zhvillohet procedura ankimore janë të obliguar që me kërkesë të anëtarit kundër të cilit zhvillohet procedura partiake të sigurojnë prezencën e një anëtari/e të PSD-së si mbështetje të tij në kontest.

Për shqyrtimin gojor mbahet procesverbal me përmbajtjen e shqyrtimit. Pjesëmarrësit e shqyrtimit mund të kërkojnë që deklaratat e veçanta tekstualisht të hyjnë në procesverbal.

Neni 20.

Vendimet nga neni 19. paragrafi 1., 3., dhe 4. duhet të jenë në formë të shkruar, të arsyetuara, të përmbajnë udhëzimin për ankesë dhe anëtarit t' i dërgohen me postë rekomande.

Anëtari në afat prej 15 ditësh mund t' i ankohet Këshillit Mbikëqyrës të PSD të Kosovës, i cili është i obliguar që për ankesën të vendos në afat prej 15 ditësh.

Kur vendos për ankesën e anëtarit kundër të cilit udhëhiqet procedura partiake, në mbledhje të Këshillit Mbikëqyrës në të cilin detyrimisht ftohet paraqitësi i ankesës, mund të thirret ose kërkohet deklarimi me shkrim i organit që ka miratuar vendimin e kontestuar.

Me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës mund të vërtetohet masa e shqiptuar, të ndryshohet ose të hiqet.

Deri në plotfuqishmërinë e vendimit për masën e shqiptuar, të drejtat dhe obligimet e anëtarit pushojnë.

Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës të PSD të Kosovës është definitiv.

Neni 21.

Anëtari i përjashtuar mund të paraqes kërkesë për pranim të serishëm në anëtarësi. Kërkesa i paraqitet Këshillit Mbikëqyrës të PSD të Kosovës, me mendimin paraprak të Këshillit Drejtues të degës respektivisht të qytetit.

Kërkesa për pranim të serishëm nuk mund të paraqitet para së të kaloi një vit nga dita e aprovimit të vendimit për përjashtim nga Partia.

Këshilli Mbikëqyrës i PSD është i obliguar të bie vendim për kërkesën për pranim të serishëm në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.

Neni 22.

Në veprimet (punën) e PSD-së mund të marrin pjesë dhe të bashkëpunojnë edhe simpatizuesit dhe mbështetësit e Partisë, të cilët sipas thirrjes mund të marrin pjesë edhe në mbledhjet e organeve dhe të trupave punuese, por pa të drejtë të vendosjes.

Simpatizues i Partisë konsiderohet secili që pajtohet me Programin e Partisë dhe i jep përkrahje politikës së saj, edhe pse nuk është anëtar formal i saj.

Mbështetës të Partisë konsiderohen personat fizik dhe juridik, që veç kuotizacionit, japin kontribute, ndihma dhe mjete materiale për punën e Partisë.

Simpatizuesit dhe mbështetësit e Partisë mund të kandidohen në listat e Partisë në zgjedhjet e të gjitha niveleve.

Pos evidencës së anëtarëve të rregullt, organet e Partisë mbajnë edhe evidencën e simpatizuesve dhe mbështetësve të saj.

3. ORGANIZIMI I PARTISË

Neni 23.

PSD është e organizuar sipas parimit territorial. Anëtarët e PSD mund të organizohen edhe në baza të interesit.

Në kuadër të organizimit territorial të Partisë në nivel komune, dhe të vendit mund të organizohen edhe format e interesit të punës dhe të veprimit të anëtarëve/reve të PSD.

Neni 24.

Anëtarësia e PSD-së territorialisht është e organizuar në këto forma të veprimit:

- Partia Socialdemokrate e Kosovës,
- Forumi i Gruas,
- Forumi Rinor dhe i
- Forumi i Veteranëve të PSD,
- degët komunale të PSD,
- nëndegët dhe seksionet.

Në qytetin e Prishtinës në harmoni me organizimin e vetëqeverisjes vendore, anëtarët e PSD-së mund të organizohen në më shumë degë.

Në vendbanime dhe në pjesët e vendbanimeve më të mëdha, komuna dhe qytete anëtarët e Partisë po ashtu organizohen në degë, nëndegë dhe seksione.

Në disa vendbanime dhe pjesë të vendbanimeve më të mëdha, komuna dhe qytete dhe në qytetet dhe komunat ku nuk është themeluar organizata e PSD-së, veprojnë të besuarit e PSD-së.

Neni 25.

Për lëmit e veprimit politik dhe Programor themelohen këshillat e PSD-së.

Neni 26.

Anëtarët e PSD-së mund të organizohen edhe në bazë të interesit në forume.

Forumet e PSD-së themelohen për interesa të grupeve shoqërore si: Forumi i Gruas, Rinor dhe i Veteranëve.

3.1. PSD E KOSOVËS

Neni 27.

PSD-ja është organizatë unike politike e cila përfshinë tërë anëtarësinë dhe të gjitha format e organizimit të PSD në territorin e Republikës së Kosovës.

PSD në qarkullimin juridik vepron si një person juridik.

Organet e PSD-së janë:

- Kuvendi,
- Këshilli Drejtues,
- Kryetari,
- Këshilli Mbikëqyrës,
- Kryesia,
- Nënkryetarët dhe
- Forumet.

Neni 28.

Në kuadër të PSD-së së Kosovës vepron edhe Stafi Profesional i PSD-së, si trup ekzekutiv-operativ i Këshillit Drejtues të PSD-së, Këshilli Qendror si trup politik-këshillëdhënës i PSD-së, këshillat e PSD-së dhe forumet e Partisë si forma të organizimit të interesit politik të grupeve shoqërore.

3. 2. KUVENDI I PSD

Neni 29.

Kuvendi i PSD është organi më i lartë i Partisë.
Kuvendi i PSD mund të jetë zgjedhor dhe raportues - tematik, respektivisht i jashtëzakonshëm.

Neni 30.

Kuvendi zgjedhor parimisht mbahet njëherë në 4 vjet, por detyrimisht pas zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës.

Kuvendi raportues-tematik mbahet sipas nevojë.

Kuvendi zgjedhor pas zgjedhjeve të mbajtura për Kuvendin e Kosovës duhet të mbahet në afat prej 150 ditësh nga publikimi zyrtar i rezultateve të zgjedhjeve.

Kuvendin nga paragrafi i mësipërme e thërret kryetari i PSD në bazë të vendimit të Këshillit Drejtues.

Vendimi i Këshillit Drejtues cakton dhe përmban rregullat për mënyrën e zgjedhjes dhe të numrit të anëtarëve të Kuvendit, propozimin e rendit të ditës, si dhe temat dhe raportet për Kuvendin.

Këshilli Drejtues bie vendim për mënyrën e zgjedhjes dhe numrin e anëtarëve të Kuvendit duke respektuar numrin e anëtarëve të PSD, numrin dhe përqindjen e votave të PSD-së të fituara në zgjedhjet për kuvende në komuna dhe rezultatet zgjedhore në nivel shteti.

Vendimi për thirrjen e Kuvendit publikohet 15 ditë para mbajtjes së Kuvendit zgjedhor, por 10 ditë para mbajtjes së Kuvendit raportues-tematik.

Në punën e Kuvendit marrin pjesë anëtarët e Kryesisë, Këshillit Drejtues dhe Këshillit Mbikëqyrës me të drejta të anëtarit.

Neni 31.

Kryetari i PSD është i obliguar të thërras Kuvendin kur këtë nga ai e kërkojnë Këshilli Drejtues, Këshilli Mbikëqyrës ose së paku pesë këshilla drejtuese të degëve komunale të PSD-së.

Nëse Kryetari i PSD nuk vepron në përputhje me paragrafin paraprak në afat prej një muaji ditësh, Kuvendin mund ta thërras propozuesi i autorizuar i cili në atë rast e përgatitë dhe udhëheqë me punën e Kuvendit.

Kryetari mund ta thërrasë Kuvendin nëse vlerëson së Këshilli Drejtues me vendimet e veta shkel Programin dhe Statutin e PSD-së.

Kuvendi edhe në këto raste thirret në harmoni me nenin 30 të këtij Statuti.

Neni 32.

Kuvendi i PSD:

- zgjedh anëtarët e Këshillit Drejtues dhe bën shkarkimin e anëtarëve të zgjedhur;
- Zgjedh kryetarin e Partisë,
- zgjedh anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës;
- zgjedh Kryesinë (që është organ ekzekutiv-politik), pjesë e të cilës janë nënkryetarët/et dhe sekretari/ja,
- aprovon Programin dhe Statutin e Partisë, si dhe ndryshimet dhe plotësimet e tyre;
- aprovon deklaratat dhe akte tjera politike;
- përcakton orientimet dhe qëndrimet e Partisë, si dhe vendosë për format e bashkëpunimit me partitë tjera politike dhe asociacionet vendore e ndërkombëtare;
- shqyrton dhe aprovon raportet për punën e Këshillit Drejtues, Kryetarit, Këshillit Mbikëqyrës dhe të Kryesisë;

- vendos për besimin e kryetarit të Partisë, anëtarëve të Kryesisë dhe për shpërndarjen e Këshillit Drejtues dhe Këshillit Mbikëqyrës në harmoni me Statutin;
- bie Rregulloren për punën vet;
- shqyrton çështje tjera lidhur me veprimin e PSD.
Në rrethana të gjendjeve të jashtëzakonshme, kur Kuvendi nuk mund të tubohet për të ushtruar veprimtarinë e vet, kompetencat e tij i merr Këshilli Drejtues.

Neni 33.

Kuvendi i PSD mund të bie vendime të vlershme nëse në te janë prezent së paku dy të tretat nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Kuvendit, ndërsa vendimet i merr me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm.

Nëse për të njëjtën çështje ekzistojnë më shumë propozime, i aprovuar konsiderohet ai i cili fiton numër më të madh të votave të anëtarëve prezent në Kuvend.

Përgjatimisht, me rregulloren e punës ose me vendim të posaçëm, Kuvendi mund të parasheh procedurë të veçantë për miratimin e vendimeve në më shumë rrahe të deklaramit, me atë rast nga procedura e deklaramit bien propozimet më numrin më të vogël të votave, gjithnjë deri sa me deklaramit nuk përcaktohet propozimi i cili ka fituar shumicën e votave të parapara me Statut.

Statuti dhe Programi i PSD aprovohen dhe ndryshohen me shumicën përtej gjysmës së votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit.

Neni 34.

Anëtarët e të gjitha organeve të PSD zgjidhen në parim me vota të fshehta ndërmjet më shumë kandidatëve.

Kuvendi mund të vendosë që votimi për anëtarë të organeve të jetë i hapur.

Në rast të numrit të njëjtë të votave të fituara për anëtar të Këshillit Drejtues dhe të Këshillit Mbikëqyrës, i zgjedhur konsiderohet kandidati i gjinisë më pak të përfaqësuar, respektivisht kandidati më i ri se 30 vjeç. Me atë rast përparësi ka kandidati më i ri se 30 vjeç.

Në rast të numrit të njëjtë të votave të fituara zgjedhja përsëritet ndërmjet kandidatëve që kanë numër të njëjtë të votave të fituara nga rrethi paraparak.

Kuvendi i zgjedh me vota të hapura Kryesinë e punës dhe trupat e veta tjera të punës. Punën e Kuvendit fillimisht e kryeson Kryetari i Partisë.

Neni 35.

Me rastin e kandidimit për të gjitha organet e PSD duhet të kihet para sysh që kandidatët të jenë më rëndësi të përgjithshme për Partinë dhe të shprehin strukturën territoriale, gjinore, të moshës, kombëtare dhe sociale të Partisë.

Me rastin e kandidimit për të gjitha organet e PSD si dhe kandidimi për trupat përfaqësuese të vetëqeverisjes lokale dhe të Kuvendit të Kosovës synohet të respektohet përfaqësimi proporcional prej së paku 40% të anëtarëve të çdo gjinie, dhe së paku 20% e anëtarëve më të rinj se 30 vjeç dhe më të moshuar se 60 vjeç, posaçërisht duke pas para sysh autoritetin dhe përkrahjen e qytetarëve kandidatëve për trupat përfaqësuese të vetëqeverisjes lokale dhe Kuvendin e Kosovës.

Nëse nuk respektohen kriteret nga paragrafi i mësipërm Këshilli Drejtues i PSD mund të korrigjoi propozimet për organe të PSD dhe kandidat për trupat përfaqësuese të vetëqeverisjes lokale dhe Kuvendin e Kosovës.

Në procedurën e kandidimit për të gjitha organet e PSD respektohet qasja e deakumulimit të detyrave të individëve.

Çdo anëtar i PSD mund të jetë i zgjedhur në çdo organ të Partisë, por njëkohësisht nuk mund të jetë anëtar i dy organeve të PSD në të njëjtin nivel të organizimit, pos anëtarit të Kuvendit, dhe nëse me Statut nuk është përcaktuar ndryshe.

Neni 36.

Dispozitat për procedurën dhe mënyrën e zgjedhjes për organe të Partisë përcaktohen me Statut, Rregulloren për punën e Kuvendit, si dhe me Rregullat për mënyrën e zgjedhjes të organeve dhe të anëtarëve të organeve të PSD, si dhe me Rregullat për kandidimin dhe zgjedhjen e kryetarit të PSD dhe të kryetarëve të degëve komunale, si dhe për kandidimin për anëtar të organeve të PSD-së.

3. 3. KËSHILLI DREJTUES I PSD

Neni 37.

Këshilli Drejtues është organi më i lartë i PSD ndërmjet dy Kuvendeve.

Këshillin Drejtues e përbëjnë 51 anëtarë që i zgjedh Kuvendi.

Mandati i anëtarëve të zgjedhur të Këshillit Drejtues është 4 vjet dhe mund të përsëritet.

Pos propozuesve të autorizuar me Statut, kandidatin për anëtar të Këshillit Drejtues mund ta propozojnë edhe së paku 25 anëtarë të Kuvendit.

Nëse ndërmjet dy Kuvendeve anëtari i Këshillit Drejtues zgjidhet në detyrë që nuk përkon me anëtarësinë në Këshillin Drejtues ose për ndonjë arsye tjetër më nuk mund të ushtroi funksionin e vet, Këshilli Drejtues në vend të tij mund të kooptoi anëtarin e ri i cili në lisën e anëtarëve për Këshillin Drejtues ka fituar numrin më të madh të votave, pas kandidatit që është zgjedh në Kuvend, ose përfaqësuesin e zgjedhur të organizatës së PSD e cila është konstituuar në ndërkohë.

Numri i anëtarëve të kooptuar në mes të dy Kuvendeve zgjedhore nuk mund të kalojë 20% të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të zgjedhur të Këshillit Drejtues.

Kryetarët e degëve të PSD-së janë njëkohësisht anëtarë të përkohshëm të Këshillit Drejtues.

Neni 38.

Këshilli Drejtues:

- zbaton dhe është përgjegjës për zbatimin e vendimeve të Kuvendit;
- përcakton propozimin e Programit dhe të Statutit si dhe ndryshimet dhe plotësimet e tyre;
- shqyrton të gjitha çështjet politike, ekonomike, sociale, si dhe çështjet tjera lidhur me veprimtarinë e Partisë, për ato merr qëndrime dhe bie vendime;
- përcakton kriteret për zgjedhje të kandidatëve për të gjitha organet e PSD dhe me kohë ua dërgon organizatave në terren;
- përcakton listën e kandidatëve për zgjedhje të organeve të cilat Kuvendi i zgjedh në harmoni me këtë Statut;
- në propozim të kryetarit të PSD-së shqyrton dhe bie programin zgjedhor dhe vendimin për kandidatët e PSD-së për përfaqësues në Kuvendin e Kosovës;
- zgjedh dhe shkarkon zyrtarët në Stafin profesional të PSD-së;
- në propozim të kryetarit të Partisë bie vendim për lidhje të marrëveshjeve për bashkëpunim zgjedhor dhe pas zgjedhor me partitë tjera politike në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës;
- në propozim të kryetarit bie vendim për kandidatin e PSD për kryetar për zgjedhje të Kryetarit të Kosovës dhe për mandatarin dhe anëtarët e Qeverisë të Republikës së Kosovës;
- emëron shtabin zgjedhore të PSD, si dhe analizon dhe vlerëson rezultatet e zgjedhjeve;
- bie vendim për bashkëpunim ndërkombëtar të PSD;
- përcakton mënyrën dhe format e mbështetjes materiale të Partisë nga anëtarët e PSD;
- zgjedh dhe shkarkon kryetarët dhe anëtarët e Këshillit Qendror në nivel të PSD të Kosovës, në harmoni me dispozitat e këtij Statuti;
- në rast të dallimeve të qenësishme në vlerësimet dhe qëndrimet ndërmjet Këshillit Drejtues dhe kryetarit të PSD me dy të tretat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve shpallë zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar të PSD;
- në rast të dallimeve të qenësishme në vlerësimet dhe qëndrimet e Këshillit Drejtues, të nënkryetarëve dhe të anëtarëve të Kryesisë mund të filloi procedurën për votimin e mosbesimit të nënkryetarëve dhe të anëtarëve të Kryesisë;
- së paku një herë në vit analizon punën e përfaqësuesve të PSD në Kuvendin e Kosovës;
- themelon trupat punuese dhe seksionet;
- për trupat e punës dhe organet që i themelon miraton rregulloret përkatëse të punës;
- përcakton politikën e qeverisjes më pronën e partisë;
- bie vendim për themelimin e stafit profesional të partisë;
- bie Rregulloren e vet të punës dhe
- kryen edhe punë tjera në harmoni me Statutin.

Neni 39.

Në rast nevojë Këshilli Drejtues mund të bie vendime me fuqi statutare të cilat nuk mund të zvogëlojnë të drejtat statutare të anëtarëve të Partisë, kompetencën e formave të veprimit të anëtarësisë dhe të organeve të Partisë në të gjitha nivelet e organizimit politik.

Përfundimisht, në rast të ndryshimit të rregullimit territorial të Republikës së Kosovës me vendim statutar mund të rregullohet ndryshe statusi dhe roli i organizatave të PSD.

Vendimet me fuqi statutare Këshilli Drejtues i bie me shumicën prej dy të tretave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit Drejtues.

Këshilli Drejtues vendimet me fuqi statutare i paraqet për verifikim në Kuvendin e radhës.

Neni 40.

Mbledhjet e Këshillit Drejtues mbahen sipas nevojë, e më së paku një herë në katër muaj. Ato i thërret kryetari i Partisë, por në rast të mungesës së tij ose të pamundësisë njëri nga nënkryetarët e partisë në mënyrën e përcaktuar me Rregullore.

Me kërkesë të kryetarit të PSD, Grupit Parlamentarë ose të 15 anëtarëve të Këshillit Drejtues, kryetari është i obliguar të thërrasë mbledhjen e Këshillit Drejtues dhe në rend të ditës të qesë ato çështje të cilat i kërkon paraqitësi i kërkesës.

Nëse kryetari në afat prej 30 ditësh nuk vepron sipas kërkesës nga paragrafi i mësipërm, Këshillin Drejtues mund ta thërrasë propozuesi i autorizuar i cili në atë rast e përgatit dhe udhëheq mbledhjen.

Në mbledhjen e tillë të Këshillit Drejtues thirren Kryetari/ja e PSD, nënkryetarët e PSD, anëtarët e Kryesisë së PSD, përfaqësuesit e PSD në Kuvendin e Kosovës, Sekretari i Përgjithshëm i PSD, kryetarët e forumeve të PSD të Kosovës, kryetari i Këshillit Qendror të PSD të Kosovës, Kryetari i Këshillit mbikëqyrës dhe kryetarët e degëve komunale.

Neni 41.

Këshilli Drejtues mund të vendosi me plotë fuqi nëse në mbledhje marrin pjesë shumica e anëtarëve, ndërsa vendimet merren më shumë se gjysmën e votave të pranishmëve.

Për miratim të vendimit për fillimin e procedurës për votimin e mosbesimit nënkryetarëve të PSD dhe të anëtarëve të Kryesisë së PSD nevojitet shumica e votave të numrit të përgjithshëm të Këshillit Drejtues.

Shumica e mbi gjysmës së numrit të përgjithshëm të anëtarëve është e nevojshme edhe për aprovimin e vendimit të Këshillit Drejtues për kandidatët për përfaqësues në Kuvendin e Kosovës.

Këshilli Drejtues për të gjitha çështjet në parim vendosë hapur. Këshilli Drejtues mund të vendosë që votimi për cilëndo çështje nga fushëveprimi i vet të jetë me vota të fshehura.

Neni 42.

Mbledhjen e parë të Këshillit Drejtues e thërret dhe e kryeson kryetari i PSD-së.

Mbledhja konstituive e Këshillit Drejtues do të mbahet në afat prej 8 ditësh nga zgjedhja e anëtarëve të tij.

3.4. KRYETARI E PSD

Neni 43.

Kryetari i PSD-së e paraqet, përfaqëson dhe udhëheq me Partinë.

Mandati i kryetarit të PSD zgjatë 4 vjet me mundësi të përsëritjes së mandatit.

Kryetarin e PSD e zgjedh Kuvendi i PSD me votim në harmoni me Rregulloren e punës që e miraton. Mënyra e kandidimit dhe zgjedhjes së kryetarit do të përcaktohet me Rregullat për kandidimin dhe zgjedhjen e kryetarit të PSD-së dhe të kryetarëve të degëve komunale, si dhe për kandidimin për anëtarë të organeve të PSD që do të jenë pjesë konkretizuese e këtij Statuti.

Neni 44.

Kryetari i PSD:

- i propozon Kryesisë dhe Këshillit Drejtues listat e kandidatëve për zgjedhje në organet e Partisë dhe në institucione tjera;
- paraqet dhe përfaqëson partinë në harmoni me ligjin, Statutin dhe Programin e PSD;
- kujdeset për zbatimin e vendimeve të Kuvendit, zbaton politikën e PSD në suaza të Programit, përcakton dhe paraqet qëndrimet politike të PSD;
- siguron bashkëpunimin e të gjitha organeve të PSD;
- propozon sekretarin e përgjithshëm dhe zyrtaret tjerë të Stafit Profesional;
- sipas nevoje, e për qellim të zbatimit të politikës së partisë thërret koordinimin e kryetarëve të organizatave komunale të PSD;
- thërret Kuvendin në bazë të Statutit ose kur vlerëson së është e domosdoshme për shkak të shkeljes së rëndë të dispozitave statutare dhe programore;
- thërret mbledhjen e Këshillit Drejtues;
- i propozon Këshillit Drejtues programin zgjedhor;
- i raporton Këshillit Drejtues për kandidatët të cilët/at organizatat e PSD i kanë propozuar kryetarit/ës dhe i propozon kandidatët/et e PSD për përfaqësues në Kuvendin e Kosovës;
- i propozon anëtarët e këshillave profesionale dhe të Këshillit Qendror, si dhe thërret e kryeson mbledhjet e Këshillit Qendror;
- kryen edhe punë tjera në harmoni me këtë Statut.

Neni 45.

Kryetari i PSD-së për punën e vet i përgjigjet Këshillit Drejtues dhe Kuvendit. Kryetari i PSD është përgjegjës për zbatimin e vendimeve të Këshillit Drejtues dhe Kuvendit.

Në propozim të Këshillit Drejtues, Këshillit Mbikëqyrës ose një të katërtës së anëtarëve të Kuvendit në Kuvend mund të iniciohet çështja e besimit ndaj kryetarit të PSD. Votimi për besimin mund ta kërkojë edhe vet kryetari i PSD. Vendimi për mosbesimin është aprovuar nëse për të ka votuar më së gjysma e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit. Me votimin e mosbesimit, shpallen zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar të PSD.

Kryetari i PSD mundet që para kalimit të mandatit të paraqes dorëheqje. Me paraqitjen e dorëheqjes shpallen zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar të PSD-së.

3. 5. NËNKRYETARËT E PSD

Neni 46.

PSD ka së paku dy nënkryetar të cilët i zgjedhë Kuvendi në kohë prej katër vitesh.

Kandidatët për nënkryetar, pos Këshillit Drejtues, mund ti propozojnë edhe së paku 26 anëtarë të KD.

Nënkryetarët e PSD mund të jenë të ngarkuar për lëmi të caktuara të Programit, ndërsa për punën e tyre i përgjigjen kryetarit të PSD dhe KD.

Këshilli Drejtues mund t' i propozoi Kuvendit që PSD të ketë më shumë nënkryetar, por jo më shumë së pesë.

Neni 47.

Nënkryetarët e PSD zëvendësojnë kryetarin sipas autorizimit të tij.

Në rast së kryetari i PSD nuk ka mundësi të caktojë së cili prej nënkryetarëve e zëvendëson, për këtë vendos Kryesia me vendimin e vet.

Neni 48.

Kryetari i PSD-së mund të filloi procedurën për votimin e mosbesimit të nënkryetarëve/reve të PSD-së.

3. 6. KRYESIA

Neni 49.

Kryesia është organ ekzekutiv-politik i PSD.

Në Kryesi zgjedhën 15 - 21 anëtarë. Këshilli Drejtues mund të vendos që Kryesia të ketë më shumë anëtarë por jo më shumë se 25.

Anëtarët e Kryesisë janë: kryetari, nënkryetarët e partisë, sekretari i përgjithshëm si dhe anëtarët e zgjedhur në Kuvendin e partisë. Kryetari i partisë sipas pozitës është kryetar i Kryesisë.

Kryetarët e forumeve të PSD-së janë anëtar të Kryesisë sipas pozite.

Neni 50.

Kryesia e PSD-së:

- zbaton Programin e PSD, vendimet e Kuvendit dhe të Këshillit Drejtues;
- debaton për nevojën e ndryshimit të Programit dhe Statutit dhe përcakton projektin e tyre,
- debaton për çështjet aktuale politike dhe për to bie vendime;
- jep mendim për propozimin e programit zgjedhor dhe propozimet për marrjen e vendimit për kandidatët e PSD-së për përfaqësues në Kuvendin e Kosovës, kandidatin për Kryetar të Republikës së Kosovës, kandidatin për mandatar të Qeverisë së Republikës së Kosovës, pastaj vendimeve për lidhjen e marrëveshjeve për bashkëpunim para dhe pas zgjedhor me partitë tjera politike në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës;
- vendosë për format e organizimit territorial dhe të interesit në parti në harmoni me Statutin.
- kujdeset për informimin brenda partisë;
- kujdeset për shfrytëzimin e mjeteve materiale të partisë dhe bie vendime përkatëse;
- lejon kontratat për fitimin, tjetërsimin dhe ngarkimin e pasurisë së PSD;
- mbikëqyrë shfrytëzimin e mjeteve materiale të partisë dhe bie vendime përkatëse;
- aprovon raportet financiare të PSD-së;
- në propozim të zyrtarit financiar pranon propozimin e planit financiar të PSD-së;
- kujdeset për mbrojtjen e lëndës arkivore dhe të dokumenteve tjera të PSD;
- themelon trupa punuese dhe seksione;
- bie edhe vendime tjera të cilat nuk janë në kompetencë të organeve tjera të partisë;
- aprovon Rregulloren e punës;
- kryen edhe punë tjera në harmoni me Statutin.

Neni 51.

Mbledhjet e Kryesisë mbahen sipas nevoje, e së paku njëherë në muaj.

Mbledhjet e Kryesisë i thërret Kryetari, por në rast mungese të tij ose të pamundësisë njeri nga nënkryetarët e PSD-së, në mënyrën e përcaktuar në nenin 47. të këtij Statuti apo me Rregullore.

3.7. KËSHILLI MBIKQYRËS I PSD

Neni 52.

Këshilli Mbikëqyrës i ka pesë ose shtatë anëtarë duke përfshi kryetarin dhe zëvendësin e kryetarit të cilët nga mesi i vet i zgjedhin anëtarët e Këshillit. Mandati i kryetarit dhe zëvendësit dhe anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës zgjatë katër vite dhe mund të përsëritet.

Kryetari edhe zëvendësi dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës nuk mund të jenë anëtarë të asnjë organi tjetër të PSD në nivel të njëjtë të organizimit pos të Kuvendit.

Këshilli Mbikëqyrës vlerëson bazën statutore të akteve dhe vendimeve të PSD, drejtpërsëdrejti merr pjesë në përgatitjen e ndryshimeve dhe plotësimeve të mundshme të Statutit të PSD, si dhe në hartimin e Statutit të ri. Në mes të dy Kuvendeve bën interpretimin e Statutit, i paraqet Kuvendit raport për punën e vet, mbikëqyrë ligjshmërinë e veprimit të PSD, si dhe kryen edhe punë tjera të parapara me Statut ose me vendime të Kuvendit.

Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës janë definitive, ndërsa moszbatimi i tyre paraqet bazë për përgjegjësi disiplinore.

Nëse me këtë Statut nuk është përcaktuar ndryshe, Këshilli Mbikëqyrës i PSD është i obliguar që në afat prej 60 ditësh të bie vendim për lëndë të posaçme.

3.8. SEKRETARI /JA I PËRGJITHSHËM I PSD

Neni 53.

Sekretarin/ën e përgjithshëm të PSD e zgjedh Kuvendi në propozim të KD të PSD. Mandati i Sekretarit/ës të Përgjithshëm është katër vjet me mundësi të përsëritjes.

Neni 54.

Sekretari/ja i Përgjithshëm i PSD:

- organizon dhe koordinon punën e organeve të PSD,
- harton dokumente për nevoja të organeve të PSD,
- ndihmon kryetarët e organeve të Partisë në thirrjen e mbledhjeve dhe organizimin e punës,
- kujdeset dhe është përgjegjës/e për zbatimin e vendimeve të kryetarit/ës, Kryesisë, Këshillit Drejtues dhe Mbikëqyrës,
- harmonizon punën e Këshillave të organizuara në nivel të PSD të Kosovës,
- kryen edhe punë tjera në harmoni me Statutin e PSD.

Sekretari/ja i Përgjithshëm i PSD për punën e vet i përgjigjet Kryesisë dhe Këshillit Drejtues të PSD.

3.9. STAFI PROFESIONAL I PSD – së

Neni 55.

Stafi Profesional i partisë është trup ekzekutiv dhe profesional-operativ i Këshillit Drejtues, Kryesisë dhe Kryetarit të partisë. Me punën e Shërbimit udhëheqë Sekretari i Përgjithshëm i Partisë.

Për punën e vet Stafi i përgjigjet Kryetarit, Sekretarit të Përgjithshëm, Kryesisë dhe Këshillit Drejtues të Partisë.

Neni 56.

Stafin Profesional të PSD-së e përbëjnë profesionist të ngarkuar për lëmi të veçanta të punës.

Vendimin për numrin e anëtarëve të Stafit, si dhe për fushën e punës së tyre në propozim të sekretarit e bie Kryesia e PSD.

Anëtarët e Stafit mund të kryejnë punën profesionalisht, për çka vendimin e bie Kryesia.

Puna dhe organizimi i Stafit rregullohet me akte të posaçme normative, në bazë të ligjeve në fuqi. Aktet e tilla i miraton Kryesia e PSD-së.

Neni 57.

Stafin Profesional e përbëjnë: Sekretari organizativ zyrtarët për financa, zyrtarët për informim dhe sekretarë teknik.

Këta zyrtar mund të kenë edhe ndihmës të tjerë nëse për këtë vendosë Këshilli Drejtues.

Kryetari në kabinetin e tij, sipas nevoje dhe mundësive, organizon stafin personal.

Neni 58.

Sekretari/ja Organizativi PSD-së:

- ndihmon sekretarin e përgjithshëm në thirrjen e mbledhjeve dhe organizimin e punës,
- harmonizon punën e organizatave komunale të PSD,
- sipas nevoje, e së paku njëherë në tre muaj thërret koordinimin e sekretarëve të degëve,
- me pëlqimin e kryetarit të partisë i paraqet Kryesisë propozimin e vendimit për organizimin e shërbimit profesional të partisë dhe të Kabinetit,
- mbikëqyrë dhe organizon punën me organizatat e Partisë: degët, nëndegët dhe seksionet,
- identifikon kandidatet potencial për zgjedhje lokale dhe nacionale i harton listat dhe i propozon kryetarit për kandidim,
- kryen edhe punë tjera në harmoni me Statutin e PSD dhe punë tjera të cilat i besohen nga kryetari dhe organet e Partisë, si dhe që i definojnë me aktet normative.

Sekretari Organizativ i PSD-së për punën e vet i përgjigjet Kryetarit, Sekretarit të Përgjithshëm, Kryesisë dhe Këshillit Drejtues të PSD.

Neni 59.

Zyrtari/ët për financa:

- kujdeset për të hyrat dhe daljet e partisë,
- qeverisë me pasurinë e partisë dhe kujdeset për personat e punësuar,
- kujdeset për fitimin dhe tjetërsimin e pasurisë së partisë, organizon aktivitetet financiare të partisë dhe punët tjera të karakterit financiar-ekonomik,
- mbikëqyr mbledhjen e kuotizacionit, si dhe buxhetin e organizatave komunale, si dhe të degëve,
- përgatit raportet financiare në harmoni me ligjet për Kryetarin dhe organet e Partisë,
- për punën e vet i përgjigjet Kryetarit të PSD, Sekretarit të Përgjithshëm dhe atij Organizativ, Kryesisë dhe Këshillit Drejtues;
- Zyrtari për financa në qarkullimin juridik e përfaqëson PSD-në.

Neni 60.

Zyrtari për financa me sekretarin organizativ koordinon dhe harton planin financiar për vitin vijues kalendarik dhe koordinon hartimin e planeve financiare të organizatave të PSD.

Planin vjetor financiar ja paraqet për lejim Kryesisë më së voni deri me 01.12 të vitit në vijim për vitin e ardhshëm.

Zyrtari për financa i Partisë Raportin materialo-financiar dhe ekonomik për afarizmin e partisë ja paraqet Kryesisë së PSD dhe Këshillit Drejtues.

Zyrtari për financa Përcakton planin vjetor financiar më së voni deri më 31.12. të vitit në vijim për vitin e ardhshëm.

Neni 61.

Kontratat për fitimin, tjetërsimin dhe ngarkimin e pasurisë së PSD-së para nënshkrimit i lejon Kryesia e PSD-së në propozimin e Stafit Profesional të PSD-së.

Neni 62.

Zyrtari/ët për informim:

- angazhohet për avancimin e informimit brenda Partisë si dhe për komunikim me mjetet e informimit masiv publik,
- është përgjegjës për organizimin e komunikimit me media të shkruara dhe elektronike,
- koordinon dhe organizon trajnimet e aktivistëve dhe të anëtarëve të Partisë,
- angazhohet dhe ka përgjegjësi për ngritjen e imazhit të Partisë,
- inicion dhe i propozon kryetarit hulumtime të ndryshme të opinionit publik për Partinë,
- mbështesin organet dhe aktivistët e Partisë në zhvillimin e strategjisë dhe të rregulloreve të ndryshme,
- kryen edhe punë tjera të cilat i besohen nga kryetari dhe organet e Partisë, si dhe që i definojnë me aktet normative.
- për punën e vet i përgjigjet Kryetarit të PSD, Sekretarit të Përgjithshëm, Kryesisë dhe Këshillit Drejtues.

Neni 63.

Kabineti i Kryetarit ka për detyrë të:

- aranzhon takimet e Partisë,
- në konsultim me Kryetarin përgatitë agjendën për takime,
- informon anëtarët për agjendën dhe kohën e vendin e takimeve,
- merr pjesë në takime dhe mbanë shënime
- incizon minutat gjatë takimeve,

- raporton për takimet e mëparshme,
- merr pjesë në takimet që mban kryetari apo nënkryetarët e partisë,
- mbanë evidencat për anëtarët e forumeve dhe të anëtarësisë së Partisë sipas ligjeve në fuqi,
- e mbështetë zyrтарin për financa në mbledhjen e kuotizacionit nga anëtarësia,
- kryen edhe punë tjera të cilat i besohen nga kryetari dhe organet e Partisë, si dhe që i definojnë me aktet normative.
- për punën e vet i përgjigjet Kryetarit të PSD-së, Sekretarit të Përgjithshëm, Kryesisë dhe Këshillit Drejtues.

4. ORGANET KËSHILLDHËNËSE TË PSD-së

Këshilli Qendror

Neni 64.

Këshilli Qendror i PSD-së është trup politik këshilldhënës i PSD-së.

Këshilli Qendror debaton për çështje të përgjithshme politike, programin dhe strategjinë e veprimit të PSD-së, propozon dokumente programore, posaçërisht lidhur me zgjedhjet, nxitë aktivitete të reja të partisë dhe të iniciativave qytetare dhe shqyrton çështje konkrete, u jep udhëzime dhe mendime organeve të partisë.

Anëtarët e Këshillit Qendror zgjidhen nga radhët e anëtarëve të dalluar të PSD-së, ndërsa anëtarë mund të jenë edhe individët e dalluar dhe punëtorët publik që nuk janë anëtarë të Partisë por pranojnë vlerat socialdemokrate dhe parimet themelore programore të PSD-së.

Kryetari i Këshillit Qendror të PSD-së është Kryetari i PSD-së ose ndonjëri nga nënkryetarët.

Kryetarët e Këshillave Profesionale të PSD-së janë sipas funksionit anëtarë të Këshillit Qendror.

Këshilli Qendror punon në mbledhje të cilat i thërret kryetari i PSD-së ose nënkryetari i autorizuar.

Në mbledhje mund të marrin pjesë edhe profesionistët e dalluar për lëmi të caktuara të cilët nuk janë anëtarë të Këshillit Qendror me ftesë të kryetarit të PSD-së.

Kryetari i PSD është i obliguar të thërrasë mbledhjen dhe të debatoi çështjet kur këtë e kërkon nga ai Kryesia ose Këshilli Drejtues.

Këshilli Qendror aprovon rregulloren e punës të Këshillit Qendror dhe të këshillave profesionale të PSD-së.

Neni 65.

Këshillat profesionale të PSD-së janë trupa profesionale këshilldhënëse të Drejtues Qendror të PSD-së dhe të trupave tjera të PSD-së.

Këshillat profesionale themelohen për lëmi të caktuara të politikave publike të cilat janë posaçërisht të rëndësishme për veprimtarinë politike të PSD-së si janë ekonomia, kultura, shkenca dhe arsimimi, shëndetësia dhe mbrojtja sociale etj.

Këshillat profesionale debatojnë për çështjet nga lëmit e politikave të caktuara publike si dhe për çështjet e përgjithshme politike lidhur me ato politika, propozojnë dokumente programore, posaçërisht lidhur me zgjedhjet, pastaj u japin udhëzime dhe mendime organeve të partisë.

Vendimin për formimin e këshillit të veçantë profesional e bie Këshilli Drejtues në propozim të Kryetarit të PSD-së, Kryesisë ose Këshillit Qendror të PSD-së.

Këshillat profesionale punojnë në mbledhje të cilat i thërret kryetari. Në mbledhje mund të marrin pjesë edhe ekspertët e dalluar për lëmi të caktuara të cilët nuk janë anëtar, me ftesë të kryetarit të Këshillit apo të PSD-së.

Anëtarët e Këshillit Profesional zgjidhen nga profesionistët e dalluar të PSD-së për politika publike të veçanta, ose në mesin e ekspertëve, të cilët nuk janë anëtar të partisë por i pranojnë vlerat socialdemokrate dhe parimet themelore programore të PSD-së.

Kryetari i Këshillit profesional është i obliguar të thërras mbledhjen dhe të shqyrtoi çështjet kur këtë nga ai e kërkon Kryetari i PSD-së, Kryesia, Këshilli Drejtues ose Këshilli Qendror i PSD-së.

Kryetarin e Këshillit Profesional të veçantë të PSD-së e zgjedh Këshilli Drejtues në propozim të Kryetarit të PSD-së.

Këshillat profesionale mund të themelohen, por pa u kufizuar në këto, si për: ligje, informim, hulumtim e analiza, organizim të projekteve, logjistikë, marrëdhënie me publikun, marrëdhënie me jashtë, plane, politika dhe programe, si dhe për fushën e financave.

Neni 66.

Në nivel të komunave mund të themelohen këshillat përkatëse të PSD-së si trupa profesionale këshillëdhënëse të nivelit përkatës të organizimit.

Vendimin për themelim, përbërjen, përmbajtjen dhe mënyrën e punës së tyre e bien Këshillat Drejtues të degëve komunale në harmoni me dispozitat për punën e Këshillit Qendror dhe këshillave profesionale të PSD-së.

Këshillat profesionale të degëve komunale të PSD-së në punën e tyre duhet të kenë mbështetjen e Këshillit Qendror të PSD-së.

5. FORMAT ORGANIZATIVE TË PSD

5. 1. Degët komunale

Neni 67.

Dega komunale është formë themelore të organizimit të anëtarëve në territorin e njësisë së organizimit territorial.

Fusha e veprimit të organizatës së PSD në parim përputhet me rregullimin administrativo-territorial të Republikës së Kosovës.

Vendimin për themelimin e organizatës e bie Këshilli Drejtues.

Dega në harmoni me Statutin dhe Programin e PSD vepron e pavarur në territorin e vet duke u kujdesur për realizimin me sukses të Programit dhe të politikës së PSD në nivel të veprimit të vet politik, por edhe për realizimin e Programit dhe të politikës së Partisë në tërësi.

Dega nuk ka status të personit juridik dhe vepron në bazë të autorizimeve, në harmoni me Statutin e PSD-së.

Neni 68.

Organet e degës janë:

- Kuvendi,
- Këshilli Drejtues,
- Kryetari,
- Këshilli Mbikëqyrës,
- Kryesia,
- Nënkryetarët dhe
- Forumet.

Dega ka një ose dy nënkryetarë. Të gjitha organet pos kryetarit dhe nënkryetarit/ëve aprovojnë Rregullore të punës.

Neni 69.

Kuvendi është organi më i lartë zgjedhor dhe programor politik i degës. Kuvendi mund të organizohet në parimin përfaqësues nëse dega numëron më shumë së 200 anëtarë, në të kundërtën të gjithë anëtarët e përbëjnë Kuvendin.

Kuvendi bie vendime të plotfuqishme, nëse në të marrin pjesë shumica prej dy të tretave nga numri i tërësishëm i anëtarëve të Kuvendit, ndërsa vendimet i merr më shumicën e votave të pranishmëve.

Përgjashtimisht, nëse dega numëron më pak së 200 anëtarë, Kuvendi merr vendime të plotfuqishme nëse në të marrin pjesë më shumë së gjysma e anëtarëve, ndërsa vendimet i merr me shumicën e votave të anëtarëve prezent.

Neni 70.

Kuvendi i degës mund të jetë zgjedhor dhe raportues-tematik.

Kuvendi zgjedhore i degës mbahet sipas rregullit në çdo 4 vjet, dhe detyrimisht deri në 90 ditë pas zgjedhjeve për trupin përfaqësues të njësisë lokale të vetëqeverisjes.

Kuvendi raportues-tematik mbahet parimisht njëherë në vit.

Kuvendin e thërret kryetari i degës në bazë të vendimit të Këshillit Drejtues të degës respektivisht të qytetit.

Vendimi i Këshillit Drejtues të degës përmban rregulla për mënyrën e zgjedhjeve dhe numrin e anëtarëve të Kuvendit, propozimin e rendit të ditës si dhe temat dhe raportet për Kuvend.

Këshilli Drejtues i degës, bie vendim për mënyrën e zgjedhjes dhe numrin e anëtarëve të Kuvendit duke respektuar numrin e anëtarëve të PSD-së, si dhe rezultatet mbi mesatare zgjedhore në territorin e pjesëve të veçanta të komunës në krahasim me rezultatet zgjedhore të PSD-së në nivelin komunal.

Përfundimisht kryetari i degës është i obliguar të thërras Kuvendin me kërkesë të Kryesisë së PSD, Këshillit Qendror të PSD, Këshillit Mbikëqyrës të PSD, Këshillit Mbikëqyrës të degës ose në bazë të kërkesës me shkrim të një të katërtës së anëtarëve të degës.

Nëse kryetari i degës në afat prej 30 ditësh nuk vepron sipas kërkesës nga paragrafi i mësipërm Kuvendin mund ta thërrasë edhe propozuesi i autorizuar i cili në atë rast e përgatitë dhe udhëheqë me punën e Kuvendit.

Neni 71.

Kuvendi i degës:

- vendosë për raportin e punës të degës, të Këshillit Drejtues të degës, të cilin e paraqet kryetari;
- vendosë për raportin e punës të Këshillit Mbikëqyrës;
- aprovon programin e punës të degës;
- me vendim të posaçëm përcakton numrin dhe përbërjen e Këshillit Drejtues;
- zgjedh për 4 vjet Këshillin Drejtues të degës, Këshillin Mbikëqyrës dhe Kryesinë;
- zgjedh përfaqësuesit e degës për Kuvendin e PSD të Kosovës në përputhje me vendimin e Këshillit Drejtues të PSD;
- sipas nevojë vendosë për besimin ndaj anëtarëve të zgjedhur të organeve të degës;
- aprovon Rregulloren e punës;
- shqyrton edhe çështje tjera me interes për PSD në nivel të njësisë lokale të vetëqeverisjes.

Neni 72.

Në degën që ka më pak së 30 anëtarë sipas parimit nuk zgjidhet Këshilli Drejtues i degës, por të gjithë anëtarët, përveç anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të organizatës, bëjnë Këshillin Drejtues të degës. Dega e këtillë zgjedh, kryetarin, nënkryetarin, sekretarin, arkëtarin dhe anëtarët tjerë të Kryesisë.

Në organizatën që ka mbi 200 anëtarë dhe e cila organizon Kuvendin sipas parimit të përfaqësimit kryetarin e zgjedhin të gjithë anëtarët.

Neni 73.

Kryetari, nënkryetarët dhe sekretari i degës njëherazi kryejnë të njëjtat detyra në nivelin e Këshillit Drejtues të degës.

Neni 74.

Në komunë ose qytet në të cilin nuk ekziston dega e PSD-së Kryesia e PSD ka për obligim të emëroi të besuarin e Partisë, i cili ka të drejtë themelore dhe detyrë që të krijoj kushte për themelimin e degës.

I besuari i tillë ka të drejta dhe detyrime si kryetari i degës së PSD-së.

Neni 75.

Këshillin Drejtues të degës e përbëjnë kryetari si dhe anëtarët e zgjedhur në Kuvend të organizatës.

Në mbledhjen e Këshillit Drejtues të degës Komunale në mënyrë obliguese ftohen këshilltarët në trupin përfaqësues të njësisë së vetëqeverisjes lokale dhe në organet e pushtetit ekzekutiv, pastaj kryetarët e forumeve dhe të Këshillave të PSD të komunës, si dhe anëtarët e organeve të PSD në nivele më të larta të organizimit, si dhe përfaqësuesit në Kuvendin e Kosovës me banim në territorin e komunës.

Nëse ndërmjet dy Kuvendeve anëtari i Këshillit Drejtues të degës zgjidhet në detyrë që nuk përkon me anëtarësinë në Këshill ose për arsye tjetër më nuk mund të ushtroi detyrën e vet, Këshilli mundet që në vend të tij të kooptoi anëtarin e ri i cili është në listën e kandidatëve dhe ka fituar numrin më të madh të votave pas kandidatëve që janë zgjedh në Kuvend ose përfaqësuesin e zgjedhur të organizatës së PSD e cila është konstituuar në ndërkohë.

Numri i anëtarëve të kooptuar ndërmjet dy Kuvendeve zgjedhore nuk mund të kaloj 20% të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të zgjedhur të këshillit.

Neni 76.

Këshilli Drejtues i degës komunale:

- takohet sipas rregullit një herë në muaj;
- drejton degën ndërmjet dy mbledhjeve të Kuvendit;
- zbaton Programin e degës, Programin dhe Statutin e PSD dhe vendimet e organeve më të larta;
- jep vlerësime politike dhe përcakton qëndrimet politike;
- vendosë dhe nxitë organizimin vendorë dhe të interesit në njësinë e vetëqeverisjes lokale;
- organizon dhe zbaton fushatën zgjedhore për trupin përfaqësues të njësisë së vetëqeverisjes lokale;
- përcakton kandidatët për organe të degës komunale të PSD-së;
- përcakton kandidatët për trupin përfaqësues të njësisë së vetëqeverisjes lokale dhe kandidatët për detyra në pushtetin ekzekutiv të njësisë lokale të vetëqeverisjes;
- së paku një herë në vit shqyrton punën e këshilltarëve dhe të anëtarëve të pushtetit ekzekutiv të vetëqeverisjes lokale dhe për këtë merr qëndrime dhe bie vendime;
- vendos për koalicione para dhe pas zgjedhjeve për trupin përfaqësues të njësisë së vetëqeverisjes lokale;
- propozon kandidatët për Kuvendin e Kosovës dhe pushtetin ekzekutiv;
- vendosë për çështje tjera në harmoni me këtë Statut.

Neni 77.

Dega që nuk zgjedh Këshill Drejtues pra zgjedh Kryesinë si dhe udhëheqësit e saj si në nenin 72. Kryesia është organ ekzekutiv-politik i degës.

Kryesia e zgjedhur e degës ka prej 5 deri në 9 anëtarë të cilët i zgjedh Kuvendi i degës. Kryesinë e përbëjnë kryetari i degës, nënkryetarët, sekretari, arkëtari dhe anëtarët e zgjedhur në Kuvend.

Kryetari i degës thërret dhe propozon rendin e ditës, si dhe kryeson mbledhjet e Kryesisë.

Neni 78.

Kryesia:

- mblidhet së paku një herë në muaj;
- debaton për çështjet aktuale dhe problemet e komunës respektivisht qytetit dhe i propozon Këshillit Drejtues të degës, respektivisht Kuvendit përcaktimin e vlerësimeve dhe qëndrimeve politike;
- nxitë organizimin partiak dhe të interesit të anëtarësisë;
- kryen edhe detyra tjera të cilat ja beson Këshilli Drejtues, respektivisht Kuvendi i degës komunale nga kompetenca e vet.

Së bashku me Këshillin Drejtues të degës komunale është bashkëpërgjegjës për punën e tërësishme të Partisë në komunë.

Neni 79.

Kryetarin e degës së qytetit respektivisht të komunës e zgjedhin të gjitha anëtarët e degës. Mënyra e kandidimit dhe zgjedhjes së kryetarit do të rregullohet me Rregullat për kandidimin dhe zgjedhjen e Kryetarit të PSD-së dhe kryetarët e degëve komunale. Rregullat për kandidimin për anëtar të organeve të PSD do të jenë pjesë përbërëse e këtij Statuti.

Dispozitat mbi procedurën e shpalljes së zgjedhjeve të jashtëzakonshme, votimit të mosbesimit dhe të dhënies së dorëheqjes të kryetarit të PSD në mënyrë përkatëse aplikohen edhe për kryetarët e degëve komunale.

Kryetari i degës thërret dhe udhëheqë mbledhjet e Kryesisë, Këshillit Drejtues të degës komunale dhe kujdeset për zbatimin e vendimeve, dhe në harmoni me kompetencat e përfaqëson organizatën. Kryetari është i obliguar që së paku një herë në vit Këshillit Drejtues të degës komunale, respektivisht Kuvendit, t' i paraqes raport për punën e vet, ndërsa për punën e vet i përgjigjet Kuvendit të organizatës.

Nënkryetari e zëvendëson kryetarin në rast të pamundësisë së tij ose të mungesës dhe i kryen punët që ja beson kryetari. Nënkryetarët për punën e tyre i përgjigjen kryetarit dhe Këshillit Drejtues, respektivisht Kuvendit. Kryetari i degës mund të filloi procedurën për votimin e mosbesimit të nënkryetarit.

Sekretari i organizatës kujdeset për zbatimin e konkludimeve dhe të vendimeve të Këshillit, ndihmon kryetarin në thirrjen e mbledhjeve, koordinon punën organizatave vendore, forumeve dhe formave tjera të organizimit të anëtarësisë, është përgjegjës për evidencën e anëtarësisë, ndërsa për punën e vet i përgjigjet kryetarit dhe Këshillit Drejtues të degës respektivisht Kuvendit.

Neni 80.

Këshilli Mbikëqyrës ka së paku tre anëtarë, për çka vendim të posaçëm bie Kuvendi i degës.

Këshilli Mbikëqyrës mbikëqyrë rregullsinë statutare të punës së organizatës dhe të organeve të zgjedhura, si dhe rregullsinë e punës së arkës.

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës nuk mund të jenë njëkohësisht bartës të detyrave, e as anëtarë të organeve dhe trupave tjera të PSD në të njëjtin nivel të organizimit, përveç Kuvendit.

Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës rregullisht ftohet në mbledhjet e Këshillit Drejtues të degës komunale.

Neni 81.

Organet e degës së PSD-së vendosin drejtësisht nëse në mbledhje është prezent shumica e anëtarëve, ndërsa për vendimin deklarohen shumica, mbi gjysma e anëtarëve të pranishëm të organit.

Organet e degës drejtësisht vendosin kur zbatohet votimi i fshehtë, nëse në votim ka marrë pjesë më së gjysma e anëtarëve të organit.

Neni 82.

Këshilli Drejtues i degës komunale është i obliguar të kërkoj mendimin paraprak të Këshillit Mbikëqyrës të PSD të Kosovës për harmonizimin e propozim rregullore me këtë Statut.

5. 2. Nëndega, Seksioni dhe tubimet e anëtarëve

Neni 83.

Në vendbanime dhe pjesët vendbanimeve më të mëdha, komuna dhe qytete anëtarët e PSD mund të organizohen në nëndegë dhe seksione.

Nëndega numëron së paku 50 anëtarë, ndërsa seksioni vendor së paku 5 anëtarë.

Vendimin për organizimin e organizatës vendore-nëndegës dhe seksionit e bie Këshilli Drejtues i degës.

Me vendimin nga paragrafi paraprak më për së afërmi rregullohet mënyra e zgjedhjes, numri dhe përbërja, pastaj përmbajtja dhe mënyra e veprimit të organizatës vendore respektivisht të nëndegës dhe seksionit.

Neni 84.

Nëndega zgjedh kryesinë, kryetarin, nënkryetarin dhe sekretarin me mandat prej katër vitesh i cili në kohë është i harmonizuar me mandatin e Këshillit i cili ka prurë vendimin për organizimin.

Seksioni zgjedh kryetarin dhe nënkryetarin me mandat prej katër vitesh i cili në kohë është i harmonizuar me mandatin e Këshillit i cili ka prurë vendimin për organizimin.

Neni 85.

Këshilli Drejtues i Degës komunale me qellim të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të anëtarësisë në përcaktimin dhe realizimin e politikës së degës të cilës i përket, si dhe të PSD-së në tërësi, mundet të thërras tubime të anëtarëve.

Në rast të numrit më të madh të anëtarëve të partisë, tubimet e anëtarësisë mund të organizohen nëpër vendbanime ose pjesë të vendbanimeve.

Këshilli Drejtues i degës është i obliguar të thërras tubime të anëtarëve në kërkesë të Grupit të këshilltarëve të PSD-së në kuvendin e komunës respektivisht të qytetit, pastaj në kërkesë të një të katërtës së anëtarësisë me vendbanim në territorin në të cilin thirret tubimi i anëtarëve.

6. GRUPI I PARLAMENTARË I PSD-së

Neni 86.

Përfaqësuesit e PSD-së të zgjedhur në Kuvendin e Kosovës për të harmonizuar veprimtarinë e vet formojnë Grupin e Parlamentar të PSD-së.

Përfaqësuesit e pavarur në Kuvendin e Kosovës mund të jenë anëtarë të Grupit Parlamentar të PSD.

Grupi Parlamentar i PSD-së për këtë bie vendim të posaçëm.

Neni 87.

Grupi Parlamentar i përfaqësueseve të PSD-së është trup i PSD-së i cili përfaqëson vlerat socialdemokrate dhe synon realizimin e Programit të PSD-së përmes veprimtarisë parlamentare dhe ligjdhënëse.

Në realizimin e veprimtarisë së vet Grupi Parlamentar i PSD-së bashkëpunon me trupat e partisë, e posaçërisht më Këshillin Drejtues të PSD-së, Kryesinë e PSD-së, kryetarin dhe me Këshillin Qendror të PSD-së.

Anëtarët e Grupit Parlamentar nga radhët e veta zgjedhin kryetarin dhe nënkryetarët e Grupit. Kryetari i Grupit mund të jetë vetëm anëtari i PSD-së.

Grupi Parlamentar e bie rregulloren e punës.

Neni 88.

Grupi Parlamentar i PSD për punën e vet i paraqet raportin vjetor Këshillit Drejtues të PSD-së. Më iniciativën e Grupit Parlamentar Këshilli Drejtues do t' i shqyrtoj të gjitha çështjet të cilat para tij i shtron Grupi.

Dispozitat nga paragrafi 1. dhe 2. i këtij neni në përputhmëni aplikohen edhe ne organizatën komunale të PSD.

Neni 89.

Kandidatët të cilët e pranojnë kandidaturën për përfaqësues në Kuvendin e Kosovës janë të obliguar të nënshkruajnë deklaratën obliguese për veprimin politik në Kuvendin e Kosovës.

Përmbajtjen e deklaratës e përcakton Këshilli Drejtues i PSD-së.

Nëse përfaqësuesi në Kuvendin e Kosovës shkelë Programin e PSD-së ose gjatë mandatit kalon në parti tjetër, Këshilli Drejtues e përjashton nga PSD-ja dhe kërkon të japi dorëheqje në detyrën e përfaqësuesit.

Dispozitat për Grupin Parlamentar të PSD-së në mënyrë përkatëse aplikohen edhe në këshilltarët, në trupat përfaqësuese në njësitë e vetëqeverisjes lokale.

7. FORMAT E ORGANIZIMIT NË BAZA INTERESI

7. 1. Forumet e partisë

Neni 90.

Forumet e PSD janë forma të organizimi politik të interesit të grupeve shoqërore të cilat veprojnë në kuadër të PSD-së dhe atë: Forumi i të rinjve, grave dhe veteranëve.

Vendimin (si akt të përgjithshëm) për themelimin e formave të organizimit në baza të interesit e bie Këshilli Drejtues i PSD-së.

Me vendimin nga paragrafi i mësipërm përcaktohet organizimi, të drejtat dhe obligimet e organizimit në baza të interesit, e që duhet të jetë në harmoni me nevojat dhe interesat e anëtarëve.

Anëtarë të forumit mund të jenë edhe qytetarët që nuk janë anëtar/e të PSD-së nëse pranojnë orientimet programore dhe politike të PSD-së.

Neni 91.

Anëtarët e bashkuar në forma të organizimit në baza të interesit në harmoni me rregullat e veta dhe dokumentet themelore programore, pastaj me vendimin për organizimin e formës së interesit nga paragrafi 2. i nenit paraprak, marrin pjesë në punën e partisë, në kuadër të degëve të PSD-së.

Rregullat, dokumentet programore dhe vendimet e forumeve nuk guxojnë të jenë në kundërshtim me Statutin e PSD-së, dokumentet programore dhe vendimet e PSD-së.

Neni 92.

Këshilli Drejtues i PSD-së me propozimin e Kryesisë së PSD-së mund të bie vendim për shpërndarjen e formave themelore të organizimit në baza të interesit të organizuara në kuadër të PSD-së në rastet:

- e ndërprerjes së punës së tyre për çka nuk realizohen qëllimet programore dhe politike të PSD-së,
- veprimeve që janë në kundërshtim me qëllimet themelore politike dhe programore të PSD-së.

Anëtarët e organizatës së shpërndarë kanë të drejtë ankese Këshillit Mbikëqyrës të PSD-së në afat prej 15 ditësh prej ditës së prurjes së vendimit të Këshillit Drejtues. Për ankesën Këshilli Mbikëqyrës duhet të vendosi në afat prej 15 ditësh.

Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës është definitiv.

Neni 93.

Nëse organet e veçanta të formave organizative të PSD-së nuk realizojnë qëllimet programore dhe politike, Këshilli Drejtues i PSD-së në propozim të Kryesisë së PSD-së mund të shpërndajë organin e tillë dhe të inicioi thirrjen ose të thërrasë Kuvendin për të zgjedh organin e ri.

Anëtarët e organeve të shpërndara kanë të drejtë ankese Këshillit Mbikëqyrës në afat prej 15 ditësh nga dita e prurjes së vendimit të Këshillit Drejtues. Për ankesën, Këshilli Mbikëqyrës duhet të vendos në afat prej 15 ditësh.

Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës është definitiv.

Deri në zgjedhje të organit të ri Këshilli Drejtues emëron të besuarin i cili është i obliguar që në afat prej tridhjetë ditësh të organizoi Kuvendin.

8. FINANCIMI DHE BAZA MATERIALE

Neni 94.

Për veprimtarinë e saj Partia siguron mjete nga kuotizacioni i anëtarësisë (si në nenin 12.), nga kontributet e personave fizik dhe juridik, ndërmarrjet e ekonomisë së Partisë, nga shitja e botimeve dhe emblemave e shenjave të Partisë, si dhe nga të gjitha burimet tjera të ligjshme.

Financimi i veprimtarisë së Partisë nga kontribuuesit mund të rregullohet me Marrëveshje përkatëse.

Ndarja dhe shpenzimi i mjeteve bëhet me Rregullore të posaçme të miratuar nga Këshilli Drejtues.

9. SHPËRNDARJA E PSD

Neni 95.

PSD mund të pushoi së vepruari me vendimin e Kuvendit, gjë për të cilën nevojiten dy të tretat e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit.

Me vendimin për ndërprerjen e punës Kuvendi do të vendosi edhe për pasurinë e PSD-së.

Fondet dhe mjetet e Partisë i dhurohen ndonjëres nga shoqatat humanitare që kanë selinë dhe veprojnë në Kosovë.

10. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 96.

Të gjitha organet e PSD-së dhe anëtarët e tyre kandidohen dhe zgjedhën në mënyrën e përcaktuar me këtë Statut dhe me Rregullat për mënyrën e zgjedhjes së organeve dhe anëtarëve të organeve të PSD-së që do të jenë pjesë përbërëse e këtij Statuti.

Procedura e kandidimit dhe zgjedhjes së kryetarit të PSD-së, kryetarëve të degëve të komunave, të cilët drejtpërsëdrejti i zgjedhin anëtarët e PSD-së, rregullohet me Rregullat për koordinimin dhe zgjedhjen e kryetarit të PSD-së, kryetarit të organizatës komunale të PSD-së dhe për koordinimin për organe të PSD-së të cilat do t' i bashkëngjiten këtij Statuti dhe do të jenë pjesë përbërëse e tij (Pas miratimit nga Këshilli Drejtues).

Neni 97.

Ky Statut hyn në fuqi dhe aplikohet prej ditës së miratimit të tij në Kuvendin e PSD-së.

Harmonizimi organizativ i degëve të PSD-së me këtë Statut do të bëhet në Kuvendet e rregullta zgjedhore të degëve. Degët e PSD-së të cilat konstituohen, organizohen sipas dispozitave të këtij Statuti.

Të gjitha aktet dhe dokumentet e PSD-së duhet të jenë të harmonizohen me këtë Statut pas hyrjes së tij në fuqi.

Neni 98.

Ditën e hyrjes në fuqi të këtij Statuti, me këto plotësime dhe ndryshime, pushon të vlejë Statuti i PSD-së i miratuar në Kuvendin e IX të PSD-së me 13 Tetor 2012.

Interpretimin autentik të këtij Statuti e bën Kuvendi i PSD, kurse sqarimet dhe interpretimin e tij praktik në mes të dy kuvendeve e bën Këshilli Mbikëqyrës.

Aprovuar nga:

Kuvendi i X-të i PSD, 17 Dhjetor 2016